



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr:259

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E VËZHguesve AFATSHKURTËR DHE PËRKTHYESVE TË AMBASADËS  
JAPONEZE, FRANCEZE, BRITANIKE, TURKE, SUEDEZE, HUNGAREZE, TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE ZVICERIANE PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE  
PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021.**

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**VENDOS:**

1. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Japoneze për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Franceze për akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 (pesë) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Britanike për akreditimin e 10 (dhjetë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 11 (njëmbëdhjetë) përkthyesve, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 3, bashkëlidhur këtij vendimi.



4. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Turke për akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Suedeze për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 5, bashkëlidhur këtij vendimi
6. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Hungareze për akreditimin 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 6, bashkëlidhur këtij vendimi.
7. Të miratojë kërkesën e Ambasadës të Republikës së Kosovës për akreditimin 5 (pesë) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 6, bashkëlidhur këtij vendimi.
8. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Zviceriane për akreditimin 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 6, bashkëlidhur këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**

